

Banka e Shqipërisë

TENDENCAT NË KREDITIM

TREMUJORI I - 2017

ERJONA SUJOTI, OLTA MANJANI DHE SOFIKA NOTE
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

PRILL 2017

Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.

P E R M B A J T J A

<i>HYRJE</i>	4
<i>PËRMBLEDHJE</i>	5
<i>1. KREDIA PËR BIZNESE</i>	7
<i>2. KREDIA PËR INDIVIDË</i>	10
<i>3. ÇMIMI I KREDISË DHE KUSHTET E TJERA TË KREDITIMIT</i>	12
<i>4. TENDENCAT E KREDITIMIT NË VENDET E RAJONIT</i>	16

HYRJE

Ky material synon të paraqesë një panoramë të tendencave të aktivitetit kreditues në vend. Për të përmbushur këtë qëllim, materiali analizon të dhënat monetare për portofolin e kredisë, si dhe kushtet e kreditimit. Gjithashtu, pjesë e këtij materiali është edhe një përmbledhje e zhvillimeve të fundit të aktivitetit kreditues në vendet e Evropës Qendrore Juglindore (EQJL).

Statistikat kryesore të analizuar në këtë material janë:

- Të dhënat për aktivitetin kreditues të bankave për sektorin rezident të ekonomisë;
- Të dhënat cilësore të marra nga vrojtimi i aktivitetit kreditues;
- Statistikat për çmimin e kredisë, si në monedhën vendase ashtu edhe në euro;
- Të dhënat monetare për vëllimin e kredisë për vendet e rajonit. Vendet e përfshira në analizë janë: Bullgari (BU), Kroaci (Cr), Rumani (RO), Serbi (Sr), Poloni (Pl), Hungari (Hu), Çeki (CZ) dhe Maqedoni (IRJM).

Materiali mbulon të dhënat e publikuara deri më 21 prill 2017, të cilat përshijnë informacion për të dhënat monetare dhe financiare për muajin shkurt 2017, dhe të dhënat e vrojtimit të aktivitetit kreditues për tremujorin e parë të vitit 2017.

PËRMBLEDHJE

Kredia për sektorin privat ka shfaqur një rritje të qëndrueshme në nivele të ulëta gjatë tremujorit të parë të vitit. Zgjerimi i portofolit të kredisë është nxitur nga kreditimi në lekë dhe nga kredia për individë. Nivelet ende të ulëta të rritjes së saj përcaktohen nga dobësia e kredisë për biznese dhe tkurrja e vazhdueshme e kredisë në valutë. Kërkesa për kredi nga sektori privat mbetet e brishtë dhe përmirësimi i likuiditetit është shfaqur në kërkesë të moderuar për kredi nga bizneset. Kjo kërkesë vijon të shoqërohet nga një ofertë e shtrënguar e bankave për këtë segment.

Zgjerimi i ritmeve të rritjes së **portofolit të kredisë për individë** ka vijuar edhe këtë fillimvit. Kredia për individë u rrit me 5.3%, e mbështetur si nga financimi për konsum ashtu edhe për blerje banese. Përmirësimi i tregut të banesave dhe zgjerimi i konsumit, së bashku me përmirësimin e besimit konsumator dhe rritjen e të ardhurave të disponueshme, kanë mbështetur rritjen e kërkesës për kredi nga ky segment. Kjo kërkesë e shtuar është akomoduar nga bankat me lehtësimin e mëtejshëm të kushteve çmim dhe joçmim për kreditë bankare. Bankat presin që edhe në tremujorin e dytë të vitit të vazhdojë tendenca pozitive në këtë segment.

Kredia për biznese ka ngadalësuar më tej ritmet e rritjes. Norma vjetore e rritjes së këtij portofoli prej 1.8% është ndër më të ulëtat në harkun kohor të një viti. Dobësia e kreditimit të bizneseve përcaktohet si nga kushtet ende të shtrënguara të kreditimit nga bankat, ashtu edhe nga kërkesa e ulët nga ky segment. Kjo e fundit vlerësohet të reflektojë praninë e kapaciteteve të lira prodhuese, akumulimin e likuiditeteve të bizneseve, si dhe shtyrjen në kohë të projekteve të investimit. Kredia për biznese ka vijuar të zhvendoset drejt kreditimit në lekë, drejt financimit të investimeve dhe për sektorin e tregtisë, hoteleve dhe restoranteve.

Normat e interesit të kredisë, si në lekë ashtu edhe në euro, janë më të ulëta në tremujorin e parë të vitit 2017 se në tremujorin paraardhës. Normat e interesit në lekë kanë rënë për bizneset, por janë rritur lehtësisht për individët. Ndërkohë, interesat e kredive në euro kanë shënuar rënie si për bizneset ashtu edhe për individët. Pjesa më e madhe e kushteve joçmim për kreditë e dhëna ka qenë në kahun lehtësues. Përgjatim bën kërkesa për kolateral për bizneset, e cila mbetet e shtrënguar.


Kredia në rajonin e EQJL-së ka shfaqur ngadalësim të ritmeve të rritjes në muajt janar-shkurt krahasuar me tremujorin e fundit të 2016-ës. Segmentimi rajonal ka filluar të zbehet, teksa ngushtohet diferenca midis normave të rritjes në vendet e Ballkanit dhe në vendet e Evropës Qendrore. Ky zhvillim ka

ardhur kryesisht si pasojë e ngadalësimit të normave të rritjes në rajonin e Evropës Qendrore, ndërsa rajoni i Ballkanit ka ruajtur thajse të njëjtat norma zgjerimi në muajt e fundit. Ecuria e kredisë në Shqipëri shfaqet pranë normave të rritjes së vendeve të tjera të rajonit.

1. KREDIA PËR BIZNESE¹


Gjatë tremujorit të parë të vitit 2017, ecuria e dobët e kredisë për biznese ka vazhduar, e ndikuar si nga kërkesa e ulët për kredi ashtu dhe kushtet e shtrënguara të kreditimit nga bankat. Përmirësimi i aktivitetit ekonomik ende nuk ka sjellë shfrytëzimin e plotë të kapaciteteve prodhuese, por ai ka ndikuar në shtimin e likuiditetit të bizneseve dhe në një rritje të ulët të kërkesës për kredi nga ky segment. Kredia për biznese në muajt janar-shkurt shënoi një rritje vjetore me 1.8%. Ky zgjerim është mbështetur nga kredia në lekë, për investime dhe në sektorin e tregtisë, hoteleve dhe restoranteve. Bankat presin një situatë të ngjashme edhe në tremujorin e dytë të vitit 2017.

Teprica e kredisë për biznese në fund të muajit shkurt përbënte 67.8% të totalit të kredisë për sektorin privat. Ecuria e dobët e kredisë për biznese në harkun kohor të një viti ka diktuar rënien e peshës së këtij portofoli ndaj totalit, me rreth 0.7 pikë përqindje. Në dy muajt e parë të vitit 2017, kredia për biznese është tkurrur me 2.2 miliardë lekë përkundrejt dhjetorit 2016, duke ngadalësuar më tej ritmet e rritjes vjetore, në 1.8%. Ky ngadalësim ka ardhur si nga tkurrja e kreditimit në valutë për biznese, ashtu edhe nga ajo për likuiditet. Këto zhvillime janë pasqyruar në një kontribut më të ulët në rritjen e kredisë totale, në 1.2 pikë përqindje përkundrejt 1.6 pikë përqindjeje të dhënë një tremujor më parë apo 2.2 pikë përqindjeje që shënonte para një viti. Ecuria e dobët e kredisë për biznese është rezultante e kërkesës ende të dobët për kredi, si dhe kushteve të shtrënguara të kreditimit të ofruara nga bankat, veçanërisht për segmentin e korporatave. Rimëkëmbja e kërkesës për kredi nga ky segment mbetet e dobët, e lidhur si me likuiditetin e shtuar ashtu edhe me përdorimin e lartë të levës financiare në të.




¹ Të dhënat e kredisë për biznese përjashtojnë efektin e kredive të riklasifikuara në zërat jashtë bilancit.

Rritja e kredisë për biznese është përcaktuar nga kreditimi në lekë, i cili vijon të rritet me ritme të larta prej 10.5%, normë kjo ndër më të lartat e katër viteve të fundit. Megjithatë, zhvillimet mujore të dy muajve të parë të vitit tregojnë që krahas tkurrjes së portofolit të kredisë në valutë (me 1.8 miliardë lekë), rënie të lehtë ka shfaqur edhe kredia në lekë. Kreditimi në valutë shfaqti tkurrje më të madhe vjetore, prej 2.8%, përkundrajt 1.2%, të shënuar në tremujorin e fundit të vitit 2016. Kjo ecuri është ndikuar edhe nga mbiçmimi vjetor i lekut ndaj euros. Rregulluar për këtë efekt, tkurrja e kredisë në valutë do të ishte pak më e ulët se në tremujorin e fundit të vitit 2016. Në muajin shkurt, kompozimi i kredisë së bizneseve sipas monedhave tregon se pesha e kredisë në lekë, prej 37.1%, është ndjeshëm më e lartë se niveli prej 34.2%, që shënonte një vit më parë. Përgjatë vitit të fundit, portofoli i kredisë së bizneseve po shfaq një zhvendosje të shpejtë drejt monedhës vendase, e nxitur kjo edhe nga kreditimi në lekë për qëllime investimi. Nivelet minimale të diferencës së normave të interesit të kredisë në lekë me atë në euro, krahas ndërgjegjësimit për rrezikun e kursit në kredinë në valutë kanë përkrahur këtë zhvendosje.



Sipas qëllimit të përdorimit të kredisë, vihet re se që prej verës së vitit 2016, kredia për likuiditete përgjithësisht ka shfaqur tkurrje mujore. Në fund të muajit shkurt 2017, kjo kredi ishte 0.4% më e lartë se një vit më parë, duke ruajtur të njëjtën normë rritjeje si në tremujorin paraardhës. Dobësia e këtij segmenti të kredisë për biznese reflekton natyrën afatshkurtër, si dhe rënien e kërkesës së bizneseve për përdorimin e linjave të kredisë dhe kapital qarkullues. Kjo ecuri reflekton përmirësimin e likuiditetit të tyre, sikurse vihet re nga rritja e depozitave të bizneseve pranë bankave. Ngadalësimi i kredisë për likuiditete është kompensuar nga zgjerimi i kredisë për investime. Norma vjetore e kredisë për investime në muajin shkurt shënoi 3.0%, nivel ky pranë mesatares së rritjes vjetore të këtij portofoli në vitin 2016. Prej më shumë se katër vitesh, norma e rritjes së këtij portofoli ka mbetur e qëndrueshme rreth këtij niveli. Në fund të muajit shkurt, kredia për investime përbënte 55.3% të kredisë për biznese ose 1 pikë përqindje më e lartë se një vit më parë.

Grafik 3. Vlera e shtuar dhe kredia për biznese sipas sektorëve të ekonomisë*




*Shënim: Të dhënat për tremujorin e parë 2017 janë përafër me të dhënat deri në muajin shkurt.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sipas sektorëve të ekonomisë, vihet re se bankat kanë vijuar të mbështesin me kredi sektorin e tregtisë, hotelerisë dhe restoranteve. Kredia për këtë sektor shënoi një rritje vjetore prej 5.2% në muajin shkurt, përkundrejt rritjes prej 4.0% në tremujorin paraardhës. Për pasojë, pesha e kredisë së këtij sektori ndaj totalit të kredisë për biznese u rrit në 43.4%, nga 41.7% një vit më parë. Në rritje të moderuar gjatë këtyre dy muajve ka qenë edhe kredia për sektorin e ndërtimit dhe ajo për sektorin e bujqësisë, të cilat u rritën me 1.3% secila. Ndërkohë që kredia për sektorin e industrisë dhe ajo për sektorin e shërbimeve u tkurrën përkatësisht me 2.4% dhe 1.1% në terma vjetorë. Në fund të muajit shkurt, kredia për sektorin e ndërtimit dhe ajo për atë të shërbimeve përfaqësonin përfaqësonin përfaqësonin 14% të kredisë për biznese secila, ndërsa ajo për industrinë 27%. Sektori i bujqësisë vijon të zërë një peshë të papërfillshme në kredinë totale të bizneseve, prej 1.5%. Në krahasim me një vit më parë, vihet re se kredia për sektorin e ndërtimit dhe ajo për sektorin bujqësor kanë qëndruar në të njëjtat nivele, ndërkohë që është ulur me 1.1 pikë përqindje pesha e kredisë për industrinë. Dinamikat e kredisë sipas sektorëve të ekonomisë janë në linjë me të dhënat e ekonomisë reale për zgjerimin e aktivitetit ekonomik të tyre.

2. KREDIA PËR INDIVIDË²


Kredia për individë ka shfaqur rritje të qëndrueshme në tremujorin e parë të vitit 2017, e mbështetur si nga financimi për konsum ashtu edhe ai për blerje banese. Zgjerimi i portofolit të kredisë për individë ka reflektuar njëkohësisht rritjen e kërkesës për financim nga individët dhe lehtësimin e kushteve të kreditimit të tyre nga bankat. Bankat presin që kjo ecuri të vazhdojë dhe në tremujorin e dytë të vitit.

Në fund të muajit shkurt, raporti i kredisë për individë ndaj kredisë për sektorin privat kulmoi në 32%. Përmirësimi i ritmeve të rritjes së kredisë për individë prej më shumë se një viti ka mbështetur rritjen e peshës së këtij segmenti ndaj totalit. Rritja vjetore e këtij portofoli në dy muajt e parë të vitit, prej 5.3%, ishte lehtësisht më e lartë se ajo e tremujorit paraardhës. Kjo ecuri pozitive është mbështetur si nga lehtësimi i kushteve të kreditimit të bankave, ashtu edhe nga kërkesa e shtuar nga individët. Rritja e konsumit në ekonomi, e shoqëruar me përmirësimin e kushteve në tregun e punës, rritjen e të ardhurave të disponueshme, si dhe forcimin e besimit të individëve, kanë mbështetur kërkesën për kredi. Po kështu, niveli i ulët i përdorimit të levës financiare tek individët, formalizimi i tregut të punës, së bashku me performancën më cilësore të kredisë për këtë segment, e ka bërë kreditimin e individëve më tërheqës për bankat.



² Të dhënat e kredisë për individë përjashtojnë efektin e kredive të riklasifikuara në zërat jashtë bilancit.

Zgjerimi i portofolit të kredisë për individë është mbështetur nga kredia në lekë. Në fund të muajit shkurt, kredia në lekë për individë shënoi një rritje vjetore prej 11.4%, më e larta e viteve të fundit. Kjo rritje ka kompensuar tkurrjen prej 2.8% të kredisë në valutë për individë, si dhe ka ndikuar në rritjen e peshës së kredisë në lekë në këtë segment. Në fund të muajit shkurt, kredia në lekë për individë përbënte 58% të kredisë për individë, përkundrejt 55% që përbënte një vit më parë. Nivelet e ulëta të normave të interesit në lekë për individët dhe afrimi i tyre me normat e interesit të kredisë në euro, ka rritur preferencën e marrjes së kredisë në lekë. Gjithashtu, edhe politikat e bankave për të përputhur monedhën e financimit me monedhën e të ardhurave, kanë ndihmuar në rritjen e ndërgjegjësimit të individëve për rrezikun e kursit të këmbimit dhe ka forcuar preferencën e tyre për kredimarrjen në lekë.




Rritja e kreditimit në lekë është vërejtur si për kredinë për konsum, ashtu edhe për kredinë për banesa. Zgjerimi i portofolit të kredisë konsumatore vijoi me norma të larta rritjeje, prej 9.8%, edhe në dy muajt e parë të vitit. Kjo rritje është mbështetur edhe nga ofertat e bankave për kredi pa kolateral, si dhe nga përmirësimi i infrastrukturës së shërbimit të klientëve³, të cilat ndihmojnë në forcimin e marrëdhënieve të bankave me klientët e tyre individë dhe nxisin kërkesën për kredi. Paralelisht me rritje ka qenë edhe kredia për banesa. Rritja vjetore e këtij portofoli u përmirësua në 4.5%, përkundrejt 3.2%, që shënonte një tremujor më parë. Zhvillimet pozitive në tregun e banesave dhe perceptimi për arritjen e nivelit minimum të normave të interesit, kanë nxitur kërkesën për kredi. Gjithashtu, kjo kërkesë është shoqëruar me një përfaqesje më favorizuese të bankave ndaj këtij segmenti, jo vetëm nëpërmjet kushteve çmim më të mira, por edhe nëpërmjet atyre joçmim. Në fund të muajit shkurt, kredia konsumatore përbënte 29% të portofolit të kredisë për individë, ajo për banesa 65.7% dhe pjesa tjetër është kredi për ushtrim aktiviteti.

³ Përmirësimi i infrastrukturës i referohet *digital banking* apo produkteve të tjera që bankat kanë prezantuar për individët.

3. ÇMIMI I KREDISË DHE KUSHTET E TJERA TË KREDITIMIT

Normat e interesit të kredisë në muajt janar dhe shkurt janë më të ulëta se në tremujorin e mëparshëm. Normat e interesit në lekë kanë rënë për bizneset, por janë rritur për individët. Ndërkohë, interesat e kredive në euro kanë shënuar rënie si për bizneset ashtu edhe për individët. Pjesa më e madhe e kushteve joçmim për kreditë e dhëna ka qenë në kahun lehtësues. Kërkesat për kolateral për bizneset mbeten veçanërisht të shtrënguara.

Norma e interesit të kredisë në lekë në muajt janar dhe shkurt shënoi përkatësisht 7.52% dhe 7.20%, duke rënë kundrejt tremujorit të mëparshëm. Sipas maturitetit, rënia e normave të interesit është vërejtur për kreditë afatshkurtra, ndërkohë që normat e interesit për kreditë afatmesme e afatgjata janë rritur lehtësisht. Në terma mesatarë, interesi në këta dy muaj është 0.39 pikë përqindje më i ulët se në tremujorin e katërt të vitit të kaluar⁴. Ai është gjithashtu 0.43 pikë përqindje më i ulët se një vit më parë, duke shprehur rënien në të gjitha segmentet e kredisë.




Paralelisht, normat e interesit të kredisë së re në euro gjatë dy muajve të parë të vitit kanë qëndruar pranë niveleve mesatare të tremujorit të kaluar. Ato rezultuan mesatarisht 4.62% në këta dy muaj, duke qenë 0.1 pikë përqindje më të ulëta se një tremujor më parë. Kjo ecuri ka reflektuar norma më të ulëta të interesit për kreditë afatgjata, ndërkohë që norma e interesit për kreditë afatshkurtra ka qenë e qëndrueshme. Në krahasim me një vit më parë, norma

⁴ Krahasimi është bërë duke përjashtuar nga llogaritjet e mesatares së tremujorit të katërt një kredi të dhënë një kompanie publike me normë interesi preferenciale.

e interesit për kreditë në euro është rreth 0.8 pikë përqindje më e ulët, duke pasqyruar rënien për të gjitha maturitetet.

NORMAT E INTERESIT PËR KREDITË PËR BIZNESET PRIVATE


Norma mesatare e interesit për kredinë e re në lekë për bizneset private ka shënuar rënie në muajt janar dhe shkurt. Ajo rezultoi mesatarisht 7.34%, nga 8.03% që regjistroi në tremujorin e katërt të vitit të kaluar. Kjo rënie ka reflektuar normën më të ulët për kreditë overdraft të bizneseve, e cila ka rënë me rreth 1.16 pikë përqindje kundrejt tremujorit të mëparshëm. Normat e interesit për kapital qarkullues kanë mbetur të pandryshuara, ndërkohë që ato për kreditë për investime pajisjesh janë rritur me rreth 0.96 pikë përqindje. Parë në një horizont kohor më të gjerë, normat e interesit për kreditë në lekë për bizneset private janë më të ulëta për të gjitha segmentet, veçanërisht për kreditë për investime. Kështu, norma mesatare e interesit për periudhën janar-shkurt 2017, është rreth 0.33 pikë përqindje më e ulët se në vitin 2016 dhe 0.5 pikë përqindje më e ulët se në vitin 2015.



Norma mesatare e interesit për kreditë në euro për bizneset private rezultoi mesatarisht 4.76% në muajt janar dhe shkurt, ose 0.1 pikë përqindje më e ulët se në tremujorin e mëparshëm. Rënia ka qenë e pranishme në kreditë për financimin e nevojave për likuiditet, veçanërisht për kreditë për kapital qarkullues. Ndërkohë, norma e interesit për financimin e investimeve ka mbetur pranë niveleve mesatare të tremujorit paraardhës. Norma e interesit për kreditë në euro të bizneseve ka ndjekur një trend të dallueshëm rënës vitet e fundit. Ajo ka zbritur në nivelet aktuale, nga mesatarisht 5.96% dhe 5.14%, që shënonte në vitet 2015 dhe 2016. Rënia ka qenë e pranishme në të gjitha llojet e financimit.

NORMAT E INTERESIT PËR KREDITË PËR INDIVIDË

Normat e interesit për kreditë në lekë për individë kanë shënuar rritje në dy muajt e parë të vitit. Interesi mesatar rezultoi 7.52% në këta dy muaj, ose 0.45 pikë përqindje më i lartë se në tremujorin e mëparshëm. Rritja e normave të interesit vërehet tek të gjitha segmentet, por është më e dallueshme tek kreditë overdraft. Në dy vitet e fundit, normat e interesit për individët ka shfaqur trendin më të fortë rënës, ndihmuar, krahas politikës monetare, edhe nga rritja e konkurrencës mes bankave në këtë segment të kredisë. Në terma mesatarë, ajo ka zbritur nga 10.0% në vitin 2014, në 8.7% në vitin 2015 e më tej në 7.2%, në vitin 2016. Ndërkohë, niveli aktual i normave të interesit mbetet më i ulët se një vit më parë, përpara uljes së normës bazë të interesit me 0.5 pikë përqindje. Rritja e tyre në muajt e fundit ka reflektuar rritjen e *yield-it* 12-mujor në fundvitin e kaluar, i cili shërben si normë referencë për kreditë për individë.




Sikurse për bizneset, edhe individët kanë përfituar norma më të ulëta interesi për kreditë në euro. Në muajt janar dhe shkurt, norma mesatare e interesit për këto kredi rezultoi 3.89%, ose 0.18 pikë përqindje më e ulët se në tremujorin e mëparshëm. Rënia e normave të interesit ka qenë e pranishme në kreditë hipotekare dhe ato për financimin e konsumit afatshkurtër, ndërkohë që normat e interesit për kreditë e tjera janë rritur. Sikurse edhe për kreditë në lekë, normat e interesit për kreditë në euro gjatë dy viteve të fundit janë ulur, por në një masë më të vogël.

KUSHTET JO ÇMIM TË FINANÇIMIT

Bankat vijojnë të kenë një përjasje të kujdeshme kundrejt kreditimit të bizneseve. Ato kanë shtrënguar sërish standardet e kreditimit për këtë segment, për të gjitha llojet e financimit. Elementi nëpërmjet të cilit është realizuar shtrëngimi i standardeve ka qenë rritja e kërkesave për kolateral. Ky standard mbetet dallueshëm në kahun shtrëngues të kushteve prej një periudhe të gjatë

kohe, në reflektim edhe të vështirësive që kanë hasur bankat në trajtimin/ekzekutimet e kolateraleve të kredive të humbura. Ndër elementet e tjerë joçmim, maturiteti i kredisë nuk ka ndryshuar, ndërkohë që madhësia e kredisë rezulton në kahun shtrëngues. Marzhi për kreditë me rrezik të lartë, i cili vitet e mëparshme ka shërbyer si element i rëndësishëm nëpërmjet të cilit bankat shtrëngonin standardet e kreditimit për bizneset, nuk ka ndryshuar që nga viti i kaluar.




Bankat mbeten më pozitive dhe aktive kundrejt kreditimit të individëve. Konkurrenca mes bankave është materializuar në lehtësim të vazhdueshëm të kushteve të kreditimit për individët, për kredinë hipotekare dhe më shumë për atë konsumatore. Në tremujorin e parë të vitit, ato kanë lehtësuar kërkesat për kolateral dhe për raportin kësht/të ardhura, nuk kanë ndryshuar madhësinë maksimale të kredisë, dhe kanë ulur (shtrënguar) lehtësisht maturitetin maksimal të saj.

4. TENDENCAT E KREDITIMIT NË VENDET E RAJONIT


Rritja me ritme të ngadalësuara e kredisë në rajonin e EQJL-së, e shfaqur në tremujorët e fundit, ka vijuar edhe në muajt janar dhe shkurt të këtij viti. Segmentimi rajonal ka filluar të zbehet, teksa ngushtohet diferenca midis normave të rritjes në vendet e Ballkanit dhe në vendet e Evropës Qendrore. Ky zhvillim ka ardhur kryesisht si pasojë e ngadalësimit të normave të rritjes në rajonin e Evropës Qendrore, ndërsa rajoni i Ballkanit ka ruajtur thajse të njëjtat norma zgjerimi në muajt e fundit. Ecuria e kredisë në vend është e ngjashme me normat e rritjes së vendeve të tjera të rajonit.

Kredia për sektorin privat në vendet e rajonit të EQJL-së shënoi ngadalësim të normave vjetore të rritjes, në 1.9% mesatarisht në muajt janar-shkurt, krahasuar me 3.3% në tremujorin paraardhës. Ecuria sipas rajoneve më të ngushta, tregon për ngadalësim më të ndjeshëm të financimit të ekonomisë në Evropën Qendrore. Prirje ngadalësuese e aktivitetit kreditues vërehet edhe në rajonin e Ballkanit në dy muajt e parë të vitit. Në vërtetimin e fundit të aktivitetit kreditues në vendet e EQJL-së për gjysmën e dytë të vitit 2016, ekspertët bankarë shprehën se, pavarësisht perceptimit për rritje të kërkesës për kreditim, oferta bankare mbetet relativisht e shtrenguar⁵. Kjo sjellje ka ndikuar në thellimin e mëtejshëm të hendekut midis kërkesës dhe ofertës dhe rrjedhimisht në ngadalësimin e kreditimit të ekonomisë.




⁵ Për më shumë rreth vërtetimit të aktivitetit kreditues në vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore, Gjashtëmuji II, 2016: http://www.eib.org/attachments/efs/economics_cesee_bls_2016_h2_en.pdf

Ecuria e kredisë në rajonin e Evropës Qendrore është ndikuar më së shumti nga zhvillimet në Poloni e Çeki, ku gjatë dy muajve të parë të vitit ritmet e kreditimit kanë shfaqur ngadalësim. Nga ana tjetër, në Hungari vërehet zbutje e normave të tkurrjes së kredisë për sektorin privat. Rritja e plogësht e kredisë në rajonin e Ballkanit kushtëzohet nga përkeqësimi në tkurrjen e kredisë në rastin e Kroacisë, ndërsa zgjerimi i saj është mbështetur nga vende si Rumania, Bullgaria e Serbia. Kreditimi i ekonomisë vendase është në linjë me zhvillimet në rajon, ku ajo kushtëzohet nga oferta ende e shtrënguar e bankave, ndërsa kërkesa për kredi perceptohet në rritje.



Financimi nga sistemi bankar sipas agjentëve ekonomikë tregon për performancë të dobët të kredisë dhënë për biznese. Pavarësisht pritjeve për lehtësim të kushteve të kreditimit dhe rritje të kërkesës nga bizneset, veçanërisht në segmentin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, ato nuk duket të jenë materializuar plotësisht në periudhën janar-shkurt. Krahas ngadalësimit të normave të rritjes së kredisë për këtë segment në vendet e Evropës Qendrore, në rajonin e Ballkanit, ajo vijon të mbetet në territor negativ. Kjo ecuri ka reflektuar në një masë të gjerë tkurrjen e kredisë për këtë segment, kryesisht në Rumania dhe Kroaci. Në linjë dhe me zhvillimet në rajon, financimi i segmentit të bizneseve me kredi bankare në vend shfaqet i luhatsëm dhe disi i paqëndrueshëm. Kjo ecuri reflekton problematika të ngjashme me vendet e tjera, e diktuar kryesisht nga kushte ende të pafavorshme për këtë segment nga ana e ofertës.

Grafik 12. Kredia për individë në vendet e rajonit



Kredia për individë ka shënuar ngadalësim të normave të rritjes, por ajo udhëheq rritjen e kredisë në rajonin e EQJL-së. Norma e rritjes së portofolit mbetet në territor pozitiv thuajse në të gjitha vendet, përveç rastit të Hungarisë. Kreditimi i individëve është mbështetur vazhdimisht nga përmirësimi në kushtet e kreditimit dhe kërkesa në rritje e individëve, veçanërisht për financim konsumi. Megjithatë, në vrojtimin e fundit të vendeve të EQJL-së raportohet shtërëngim i kushteve të kreditimit për individët –përqendruar në segmentin e kredisë hipotekare dhe pritje për sjellje të ngjashme në gjashtëmujorin e ardhshëm. Këto zhvillime duket të jenë materializuar në periudhën janar-shkurt, duke ndikuar në ngadalësimin e normave të rritjes së këtij portofoli gjatë kësaj periudhe. Ecuria e kredisë për individë në vend rezulton relativisht e qëndrueshme, duke reflektuar si rritjen e kërkesës ashtu edhe përmirësimin e kushteve të kredisë për këtë segment.